

Në kuadër të Ditës Botërore të Librit, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Njësine Bazë të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë dhe Njësine Bazë të Metodologjisë së Mësimdhënies, organizoi promovimin e librit për fëmijë "Ngjyrat e Stinëve", të studentes Paola Muçodemi.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte promovimi i leximit që në moshë të hershme, nxitja e krijimtarisë letrare te studentët, si dhe ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e librit në zhvillimin intelektual dhe emocional të fëmijëve.

Aktiviteti synoi gjithashtu të krijonte një hapësirë bashkëbisedimi dhe shkëmbimi idesh ndërmjet studentëve, pedagogëve dhe të pranishmëve, duke vlerësuar ndihmesën e të rinjve në fushën e letërsisë.

Ky aktivitet u realizua nën udhëheqjen e pedagogëve Prof.Asoc. Merita Gjokutaj, e cila ka kryer redaktimin e librit, si dhe Doc. Harallamb Margariti.

